

TË PËRGJITHSHME

Microtech Computer Systems është regjistruar në regjistrin tregtar në QKB dhe në zyrën Rajonale Tatimore të Tiranës më 17/03/2022, me NIPT M21517046I, me aktivitet kryesor Shërbime në fushën e sistemeve të teknologjise së informacionit dhe komunikacionit, shitblerje, zhvillim software, shërbime transmetimi dhe përpunim të dhënash, operacione të ndryshme komisionere. Përgatitje dokumenta për pjesmarrje në tendera, veprime marketingu, menaxhim i pagesave të furnitoreve. Shërbim marketingu, distribucioni, konsulence dhe studim tregu. Tregtim pajisjesh kompjuterike hardware, kancelari të ndryshme dhe pajisje zyre. Instalim e sisteme sigurie CCTV, fonie, rrufepritese dhe sisteme të specializuara. Të zhvillojë aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së software (programe), dizënim dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe bazës së të dhënave, analizë, zhvillim, programim (kodim), integrim i komponenteve, trajnime, instalime, konsulenca, implementime dhe të tjera ndihmëse në këtë fushë, ndjekje të proceseve, kolaudim, korrigjim, deri në produktin përfundimtar duke realizuar zgjidhje informatike, plotësim i sistemit informatik me elementet e sigurisë, privatesise etj, zhvillim në kohë të ndryshme, duke garantuar upgrade të sistemit për të realizuar komunikime me versione të ndryshme të sistemit informatik. Rekrutim dhe menaxhim i burimeve njerëzore. Administrim dhe menaxhim të pasurive të paluajtshme. Veprimtari dhe shërbime të ndryshme publiciteti, reklama dhe promocione. Shoqëria mund të kryej edhe veprimtari të tjera ndihmëse të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të saj kryesor në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shoqëria mund të kryej gjithashtu cdo operacion financiar, tregtar, shërbimi, industrial, me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një nga objektet e sipërpermendura.

Selia e subjektit është Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga Mujo Ulqinaku, Pallati Teknoprojekt, Kati 1, Ap.1, Tiranë.

BAZA E PËRGATITJES

Deklarata e përputhshmërisë.

Pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2025, janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe të Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Mbi kontabilitetin dhe mbajtjen e pasqyrave financiare".

Bazat e matjes.

Pasqyrat financiare të subjektit janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

Monedha funksionale dhe ajo raportuese.

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në LEK, e cila është monedha funksionale e kompanisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryej gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.



Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimet përkatëse në pasqyrat financiare. Përdorimi i çmuarjeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale për vetë faktin e thjeshtësisë dhe natyrës së operacioneve që kompania kryen.

POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël më të rëndësishme janë përshkruar më poshtë:

Transaksionet në monedha të huaja.

Transaksionet në monedhë të huaj janë të paraqitur në LEK me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga zërat monetarë është diferenca që rezulton nga përkthimi i një numri të caktuar të njësive të një monedhe të huaj në lekë në kurse të ndryshme këmbimi. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj janë përkthyer në lekë me kursin e këmbimit në datën e transaksionit, ndërsa ato që janë matur me vlerën e drejtë janë kthyer në lekë me kursin e këmbimit në datën që është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që lindin nga kthimet janë njohur në pasqyrën e të ardhurave. Kurset e këmbimit në fund janë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
EUR/LEK	96.77	98.15
USD/LEK	82.46	94.26

Instrumentet financiare.

Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë llogaritë e arkëtueshme tregtare, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera. Instrumentet financiare jo-derivative janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentet jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, ndonjë kosto direkte të transaksionit, përveç siç përshkruhet më poshtë. Pas njohjes fillestare, instrumente financiare jo – derivate janë matur siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare njihen nëse të drejtat kontraktuale të kompanisë për rrjedhjet e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose nëse shoqëria transferon aktivin financiar të një palë tjetër, pa mbajtur kontrollin ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale e aktiveve financiare janë kontabilizuar në datën e tregëtimit, dmth, data që kompania angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Detyrimet financiare njihen në qoftë se detyrimet e kompanisë specifikuar në kontratë skadojnë ose janë hequr apo anuluar.

Likuiditeti dhe ekuivalentet e tij.

Likuiditeti dhe ekuivalentet e tij përfshijnë tepricat e parave në llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat e pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak nga data e krijimit.



Llogaritë tregtare të arkëtueshme.

Llogaritë tregtare të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston minus humbje nga zhvlerësimi. Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme tregtare krijohen kur ka evidence objektive që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të llogarive të arkëtueshme. Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do falimentojë ose riorganizimi financiar, si dhe mospagesa ose vonesat në pagesat konsiderohen si tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme tregtare.

Llogaritë e pagueshme.

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera të pagueshme janë paraqitur në vlerën e tyre reale dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet.

Huamarrjet paraqiten me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë.

Vlera e drejtë e likuiditeteve dhe ekuivalentëve të tij, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme dhe kredive janë të ngjashme me vlerën e tyre kontabël neto.

Metoda e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe të ndarjes së shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat e adhsme monetare gjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër.

Aktivitet afatgjatë materiale

(i) Njohja dhe matja.

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitet.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivitet. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata material përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për neto brenda “të ardhura të tjera” në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëparshme.

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata material njihet në vlerën e mbartur të aktivitet nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara përbrënda pjesës do të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.



Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata material njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Amortizimi.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qera dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata material nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivet e marra me qera zhvlerësohen përgjatë më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk zhvlerësohet. Metodatat e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Jeta e dobishme për periudhën aktuale është si më poshtë:

Aktivi	Përqindja
Makineri	20%
Pajisje elektronike	25%
Pajisje zyre	20%
Mjete transporti	20%

Inventaret.

Inventari regjistrohet fillimisht me kosto dhe amortizohet në fund të periudhës raportuese, nëse ka të dhëna për një zhvlerësim të tillë. Kostoja përfshin koston e blerjes dhe të gjitha që lidhen me sjelljen e inventarit në vendodhjen dhe kushtet aktuale, duke përfshirë tarifat doganore, transportin dhe siguracionin. Kompania përdor koston mesatare për të llogaritur inventarët në fund dhe koston e mallrave të shitura/materialeve të përdorura për prodhimin e mallrave për shitje.

Zhvlerësimi.

(i) Aktivet financiare.

Aktivi financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij të akumuluar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlerësim në mënyrë periodike. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupime që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ky anullim lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur kjo humbje. Për aktivet financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Aktivet jo-financiare.



Vlerat e akumuluar të aktiveve jo financiare rishikohen në çdo datë raportimi për përcaktuar nëse ka indikacione të zhvlerësimit. Nëse indikacione të tilla ekzistojnë, atëherë duhet të çmohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbja nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera e akumuluar e aktivitetit ose njësia gjeneruese e mjeteve monetare e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Provizionet.

Provizioni njihet atëherë kur si rezultat i një ngjarje të mëparshme, kompania ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, dhe ekziston mundësia që për shlyerjen e detyrimit do të nevojitet dalja e përfitimeve ekonomike. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset monetare të pritshme me normën para taksave, e cila reflekton vlerësimin e tregut të vlerës në kohë të parasë dhe risqet specifike të detyrimit.

Njohja e të ardhurave.

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shërbime të ofruara në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe rabatet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare.

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit dhe interes për huat bankare dhe ato nga kompania mëmë.

Tatimi mbi fitimin.

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat tatimore të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Shpërblime e punonjësve.

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Kompania nuk bën provizione dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, sapo ndodhin.

Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit.

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale.

Kompania bën vlerësime dhe hipoteza në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet rezultuese të kontabilitetit, rrallë do të barazohen me rezultatet përkatëse aktuale. Vlerësimet dhe hipotezat që



mbartin riskun e shkaktimit të një rregullimi material në vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

Taksat mbi të ardhurat.

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdesshëm. Ka një numër transaksionesh dhe llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurtë. Kompania njeh detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksa shtesë për tu paguar.

DETYRIME TË KUSHTËZUARA DHE ANGAZHIME TË MARRA

Çështjet gjyqësore dhe paditë.

Gjatë aktivitetit normal, kompania mund të përfshihet në procedime gjyqësore, padi ose procese gjyqësore me pale të treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e mundshme në të ardhmen nuk do të ketë efekte negative të rëndësishme pozicionin financiar, rezultatet e aktiviteteve ose flukset monetare të kompanisë.

NGJARJE PAS MBYLLJES SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së bilancit që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.

MJETE MONETARE DHE EKUVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
ARKA NE LEKE	41,298	0
BANKA		
LEK	6,319,809	3,111,121
EUR	1	6,215
Total	6,361,108	3,117,336

LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:


	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Llogari te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	10,568,716	13,109,178
Total	10,568,716	13,109,178

INVENTARË

Inventarë më datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Mallra për shitje	0	0
Total	0	0

AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA



MICROTECH C.S. Shpk - Shënime për Pasqyra Financiare të mbyllura në datën 31 dhjetor 2025
M215170461 - (Të gjitha shumat janë shprehura dhe rrumbullakosura në LEK)

Aktive tatimore të shtyra në datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Aktive tatimore të shtyra	-	-
Total	-	-

Në përputhje me standardet është njohur kjo shumë e mbipaguar, si aktiv i shtyrë për tu zbritur në periudhën e ardhshme.

TAKSA & DETYRIME TË PAGUESHME

Taksa të pagueshme në datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Kontribute për sigurime	41,298	41,960
Taksa mbi të ardhurat personale	11,442	9,151
Tatim mbi fitimin	0	1,649,512
Tatim ne burim	8,824	-
TVSH	59,400	673,797
Total	120,964	2,374,420

LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme në datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	5,607,747	2,960,970
Total	5,607,747	2,960,970

TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME

Llogari të pagueshme në datë 31 dhjetor 2025 dhe 2024

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Të pagueshme ndaj punonjësve	11	0
Të tjera të pagueshme - (455)	-	-
Të tjera të pagueshme - (457) Dividentë	-	-
Total	11	0

KAPITALI

Kapitali për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Kapitali i Nënshkruar	100,000	100,000
Rezerva ligjore + Rezerva tjera	-	-
108-Fitimi/Humbja e pashpërndarë	5,491,125	182,109
109-Rezultati i ushtrimit	1,580,910	10,609,015
Total	7,172,035	10,891,125

TË ARDHURA

Të ardhurat për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2025 dhe 2024 përbëhen nga sa vijon:



MICROTECH C.S. Shpk - Shënime për Pasqyra Financiare të mbyllura në datën 31 dhjetor 2025
M21517046I - (Të gjitha shumat janë shprehura dhe rrumbullakosura në LEK)

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Shitje mallrash dhe Shërbimesh	26,472,042	28,360,606
Të ardhura nga interesat	-	-
Total	26,472,042	28,360,606

KOSTO E MALLRAVE & SHËRBIMEVE TË SHITURA

Kosto e mallrave dhe shërbimeve të shitura përbëhet nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	21,043,560	12,908,736
Total	21,043,560	12,908,736

KOSTO E PERSONELIT

Kostot e personelit përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Paga për personelin	1,514,387	1,786,549
Kontributet e sigurimeve shoqërore	252,904	298,348
Total	1,767,292	2,084,896

SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera përbëhen nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Qira	-	-
Utilitete	-	-
Shpenzime shfrytëzimi	1,803,456	885,774
Gjoha dhe demshperblime	-	-
Shpenzime te tjera	-	-
Total	1,803,456	885,774

FITIM/HUMBJA NGA KURSET E KËMBIMIT

Fitimi/Humbja nga kurset e këmbimit përbëhet nga sa vijon:

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Fitim nga këmbimet dhe perkthimet valutore	2,160	-
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	-	-
FITIM/HUMBJE	2,160	-

TAKSA MBI TË ARDHURAT

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri me një normë tatimi prej 15% për 2025. Format e deklarimit të taksave dorëzohen çdo vit. Deklarimi i të ardhurave dhe



MICROTECH C.S. Shpk - Shënime për Pasqyra Financiare të mbyllura në datën 31 dhjetor 2025
M21517046I - (Të gjitha shumat janë shprehura dhe rrumbullakosura në LEK)

shpenzimeve për qëllim të taksave. konsiderohet si vet-deklarim deri sa të jetë i shqyrtuar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Fitimi i vitit para tatimit	1,859,894	12,481,199
Fitimi i tatueshëm	1,859,894	12,481,224
Tatimi mbi të ardhurat për vitin (15%)	278,984	1,872,184
Parapagime Tatim Fitimi	1,425,918	222,672
Taksa të pagueshme më 31.12.2025	0	1,649,512

MICROTECH C.S. SHPK

ADMINISTRATOR

FIORA VISHKURTI

FIORA VISHKURTI

